

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Mustafa, kryetare, Nebojsa Boriçiq dhe Avdi Dinaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit A. H., nga Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale rrëmbimi në tentativë, nga neni 194 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit A. H., G. K., av. nga Peja, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Krimeve të Rënda, P.nr.57/2016 datë 20.4.2016 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAKR.nr.306/2016 datë 5.8.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22 nëntor 2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit Agim Hadri të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Krimeve të Rënda, P.nr.57/2016 datë 20.4.2016 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë, PAKR.nr.306/2016 datë 5.8.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Departamenti i Krimeve të Rënda, P.nr.57/2016 datë 20.4.2016 i dënuari A. H. është shpallur fajtor për veprën penale rrëmbimi në tentativë nga neni 194 par. 1 lidhur me nenin 28 të KPK dhe për këtë vepër penale është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 14.4.2014 gjer më 15.5.2015. Është detyruar i akuzuari që t'i kompensojë gjykatës shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 170 € dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 30 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. E dëmtuara G. M., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore duke vendosur sipas ankesave të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë dhe asaj të mbrojtësit të të akzuarit A. H. është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nga Gjykata e Apelit Prishtinë – Departamenti për krime të rënda, PAKR.nr. 306/2016 datë 5.8.2016.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A. H., G. K., av. nga Peja, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtrësën KMLP.II.nr195/2016 datë 26.10.2016, me propozim që e njëjta të refuzohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes konform dispozitave të nenit 435 par. 1 dhe 436 par. 1 të KPPK-së, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se diapozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është kundërthënës me vetveten dhe arsyetimin e tij, duke mos i paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, duke mos dhënë arsye për tentimin e rrëmbimit. Deri sa në dispozitiv thekson se qëllimi i rrëmbimit ka qenë që të dëmtuarën ta detyrojë për martesë, ndërsa e dëmtuara thekson “...se i dënuari nuk ka dashur të më detyrojë për martesë...” duke e konsideruar si theksim arbitrar nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Po ashtu pretendon se në rigjykim, gjykata e shkallës së parë me një seancë gjyqësore ka përfunduar çështjen penale duke i lexuar provat e administruara, ndërsa vetëm e dëmtuara është dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor në cilësinë e dëshmitares.

Pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit të theksuara në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pabazuara, nga këto arsye:

Nga shkresat e çështjes është vërtetuar se ditën kritike (më 12.4.2014) e dëmtuara ka dalë nga shtëpia e saj në për t’u takuar me P. M. pasi që më parë janë marrë vesh për takimin e tyre për kthimin e ca librave, të cilat kanë qenë të të dëmtuarës. E dëmtuara nga shtëpia ka dalur rreth orës 7 dhe pas takimit (marrjes së librave) sërish kthehet në drejtim të shtëpisë. Nuk janë kontestuese rrethanat se gjatë kthimit në drejtim të shtëpisë, i dënuari vjen me automjetin e tij “Audi A 4” duke e ndalur afër të dëmtuarës, del nga automjeti dhe në çastin kur e dëmtuara fillon të ikë, i dënuari me shpejtësi vrapon pas të dëmtuarës duke e kapur për flokësh, duke e tërhequr zvarrë në drejtim të automjetit. Nuk janë kontestuese rrethanat se e dëmtuara ka rezistuar duke kërkuar ndihmë dhe në çastin kur i dënuari e hapë derën e pasme të automjetit që ta fusë të dëmtuarën në automjet, e dëmtuara shtrihet për tokë duke i kundërshtuar veprimin të të dënuarit, rrethana këto që vërtetohen edhe me dëshmitë e dëshmitares P. M. e cila hynë në një rrugë anësore duke kërkuar ndihmë. Po ashtu, nga provat e administruara është vërtetuar se dëshmitari V. M., i cili në ato çaste ka qenë duke i mjelur dhentë, dëgjon britmën e një femre, për çka ka dalë para dyerve të oborrit, me ç ‘rast sheh të dëmtuarën G. të shtrirë për tokë ndërsa i dënuari e kishte kapur për flokësh dhe në ato çaste tentonte ta fuste në automjet. Po ashtu, ky dëshmitar vërteton rrethanat se e dëmtuara kundërshtonte duke bërtitur, ku pas daljes së dëshmitarit i dënuari largohet nga vendi i ngjarjes.

Gjykata Supreme gjen se nuk qëndrojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të theksuara në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i qartë, konkret, nuk ka kundërthënie në dispozitiv e as të dispozitivit me arsyetimin e dhënë në aktgjykimet e kundërshtuara. Në arsyetim të aktgjykimeve janë dhënë arsye të bollshme faktike dhe juridike duke bërë vlerësimin e provave të administruara në pajtim me dispozitën e nenit 370 par. 7 të KPK. Faktet vendimtare janë vërtetuar në mënyrë të plotë, asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje por në mënyrë të plotë janë vërtetuar.

Qëndron fakti se në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë theksohet “... qëllimi i rrëmbimit ka qenë që ta detyrojë të dëmtuarën për martesë...” por kjo nuk e bën aktgjykimin e kundërshtuar të pa qartë dhe kundërthënës siç pretendon mbrojtësi në kërkesë për faktin se ky konstatim i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë është dhënë në bazë të pohimit të të dëmtuarës por edhe mbrojtësi duhet ta ketë pasur parasysh faktin se i dënuari është shpallur fajtor dhe është dënuar për veprën penale të ngelur në tentativë, andaj në rastin konkret është e palogjikshme të kërkohej se çfarë ishte dashja e të dënuarit që të veprojë pas rrëmbimit. Andaj, edhe arsyetimet e dhëna në aktgjykimet e kundërshtuara janë të dhëna në drejtim të veprës penale të rrëmbimit të ngelur në tentativë.

Po ashtu, qëndron fakti se shqyrtimi gjyqësor ka përfunduar brenda një viti, fakt ky që është logjik dhe normal nga arsyeja se kryetari i trupit gjykues dhe një anëtar i trupit gjykues kanë marrë pjesë edhe në shqyrtimin gjyqësor të mëparmë, se në propozim të mbrojtësit janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve ndërsa në shqyrtimin gjyqësor as i dënuari e as mbrojtësi i tij, nuk kanë pasur vërejtje në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor e nga ana tjetër këto veprime procedurale nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë ndërmarrë konform dispozitës së nenit 338 të Kodit të Procedurës Penale.

Duke pasur parasysh këtë gjendje të çështjes, kjo Gjykatë vlerëson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i gjykatës së shkallës së dytë, është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj konform dispozitës së nenit 437 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

PML.nr.256/2016 datë 22 nëntor 2016

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa